



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës : KSC-BC-2020-06

Vendosi: **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**
Gjykatëse Mishelë Pikar
Gjykatës Emilio Gati
Gjykatëse Nina Jorgensen

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 14 tetor 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën e Selimit për Ndryshimin e Numrit të lejuar të Fjalëve

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:

Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit:

Gregori Kihou

Mbrojtësit të Viktimave:

Sajmon Loz

Mbrojtësit të Kadri Veselit:

Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit:

Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit:

Venkatesvari Alagenda

PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT të Dhomave Specializuara të Kosovës (përkatësisht, “Paneli i Gjykatës së Apelit” ose “Paneli” dhe “Dhomat e Specializuara”),¹ bazuar në nenin 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe rregullën 169 të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), ka marrë në shqyrtim kërkesën e parashtruar nga Rexhep Selimi (përkatësisht, “Kërkesa” dhe “Selimi”) me anë të së cilës ai kërkon shtimin e numrit të fjalëve të lejuara për kundërpërgjigjen e tij ndaj përgjigjes së Zyrës së Prokurorit të Specializuar (përkatësisht “Përgjigja” dhe “ZPS-ja”) lidhur me apelin që ai ka bërë kundër vendimit të Gjykatës të Procedurës Paraprake lidhur me mocionet paraprake që ngrenë kundërshtime lidhur me juridiksionin (përkatësisht, “Apeli” dhe “Vendimi i Kundërshtuar”).² Selimi kërkon të lejohet të përdorë edhe 5.000 fjalë shtesë në kundërpërgjigjen e tij, duke mos tejkaluar kufirin e 8.000 fjalëve.³

1. Paneli vëren se neni 46(3) i Udhëzuesit të Punës për Dosjet e Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Udhëzuesi i Punës”)⁴ përcakton që kundërpërgjigja ndaj përgjigjes së një apeli të ndërmjetëm kundër një vendimi mbi mocionet paraprake sipas rregullës 97(3) të Rregullores nuk duhet të jetë më shumë se 3.000 fjalë. Gjithashtu, neni 36(1) i Udhëzuesit të Punës përcakton që pjesëmarrësit në proces mund të kërkojnë, paraprakisht dhe duke lejuar kohë të

¹ F00015, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 30 gusht 2021.

² F00023, Kërkesë e Mbrojtjes për Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, 13 tetor 2021 (“Kërkesa”); F00022, Përgjigje e Prokurorisë lidhur me NKP-në ndaj Apelit të Mbrojtjes së Selimit kundër Vendimit mbi mocionet që ngrenë kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, 30 shtator 2021 (“Përgjigja”); F00011, Apeli i Mbrojtjes së Selimit kundër Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, 27 gusht 2021 (“Apeli”); F00412, Vendim mbi Mocionet që ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, 22 korrik 2021 (“Vendimi i Kundërshtuar”).

³ Kërkesa, para. 1, 6.

⁴ KSC-BD-15, Udhëzuesi i Punës i Zyrës Administrative mbi Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës, 17 maj 2019 (“Udhëzuesi i Punës”).

mjaftueshme, shtimin e numrit të fjalëve në rast se provojnë se ekzistojnë arsye të vlefshme të cilat përbëjnë rrethana të veçanta.⁵

2. Duke u nisur nga rëndësia dhe kompleksiteti i disa prej aspekteve të ngritura nga ZPS-ja në Përgjigjen e saj dhe nga rëndësia e përgjithshme e kundërshtimit të juridiksionit, Selimi argumenton se ekzistojnë arsye të vlefshme për të shtuar numrin e fjalëve të kundërpërgjigjes së tij.⁶ Ai gjithashtu argumenton se numri i fjalëve është shtuar në rastet e parashtrimeve lidhur me apelet kundër Vendimit të Kundërshtuar dhe se i njëjti arsyetim justifikon shtimin e numrit të fjalëve të kundërpërgjigjes së tij.⁷

3. Për sa i përket afateve të Kërkesës, Paneli vëren se Selimi nuk ka bërë asnjë parashtrim në këtë aspekt. Paneli vëren se afati për dorëzimin e kërkesave është 18 tetori 2021⁸, më pak se një javë pas dorëzimit të Kërkesës më 13 tetor 2021, ndërkohë që Përgjigja u dorëzua më 30 shtator 2021, dhe u shpërnda të nesërmen, afërsisht dy javë para Kërkesës. Pavarësisht se Paneli gjykon se parimisht mund të pranohet që Kërkesa është dorëzuar në një afat të mjaftueshëm paraprak sipas rregullës 36(1) të Udhëzuesit të Punës, ai i kërkon Selimit – dhe palëve në përgjithësi – që të parashikojnë një kohë më të gjatë për kërkesa të ngjashme që mund të bëhen në të ardhmen.

4. Paneli është i vetëdijshëm se sa voluminoz është Vendimi i Kundërshtuar (gjithsej 98 faqe) dhe se Paneli ka miratuar shtim të numrit të fjalëve në raste të tjera lidhur me apelet e Mbrojtjes dhe përgjigjet përkatëse të ZPS-së.⁹ Në vendimet e tij të

⁵ Shih p.sh. F00009, Vendim mbi Kërkesat për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, 19 gusht 2021 (“Vendim mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve”), para. 1; F00017, Vendim mbi kërkesën për ndryshimin e numrit të lejuar të fjalëve, 24 shtator 2021 (“Vendim mbi Kërkesën e ZPS-së për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve”), para. 1.

⁶ Kërkesa, para. 4.

⁷ Kërkesa, para. 5.

⁸ Shih F00005, Vendim mbi Kërkesat për Ndryshimin e Afateve, 28 korrik 2021 (“Vendim mbi Kërkesat për Ndryshimin e Afateve”), para. 8 (ndryshon afatin për kundërpërgjigjen ndaj Përgjigjes së 18 tetorit 2021).

⁹ Vendim mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, para. 7; Vendim mbi Kërkesën e ZPS-së për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, para. 7.

mëparshme, Paneli ka pranuar se rëndësia dhe kompleksiteti i çështjeve të ngritura në Vendimin e Kontestuar, si dhe risia që ato paraqesin përpara Panelit të Gjykatës së Apelit, përbëjnë arsye të vlefshme për të ndryshuar edhe afatet edhe numrin e fjalëve të parashtrimeve të apelit kundër Vendimit të Kundërshtuar dhe ka arritur në përfundimin se mund të jetë me vlerë që Paneli të marrë parashtrime më të hollësishme se ato që lejohen normalisht, duke justifikuar devijimin e afateve dhe të numrit të lejuar të fjalëve që parashikojnë, përkatësisht, Rregullorja dhe Udhëzuesi i Punës.¹⁰ Lidhur me këtë, Paneli rikujton konkluzionin e vet të mëparshëm se është në interes të drejtësisë që palët që paraqiten para Dhomave të Specializuara të dorëzojnë parashtrime kuptimplota për apel lidhur me pikat e ngritura në Vendimin e Kundërshtuar.¹¹ Pavarësisht se parashtrimet e Selimit mbi arsyet e vlefshme për shtimin e numrit të fjalëve për kundërpërgjigjen e tij janë të një karakteri të përgjithshëm dhe nuk përmbajnë ndonjë justifikim të posaçëm, Paneli, gjithsesi gjykon se, bazuar në arsyet e sipërpërmendura, ekzistojnë arsye të vlefshme të cilat përbëjnë rrethana të posaçme që kundërpërgjigja e Selimit të tejkalojë numrin e fjalëve të parashikuara nga Udhëzuesi i Punës.

5. Sidoqoftë, Paneli vëren se kërkesa e Selimit për 5.000 fjalë shtesë për kundërpërgjigjen e tij pothuajse e trefishon numrin e lejuar të fjalëve sipas Udhëzuesit të Punës, konkretisht duke e çuar atë nga 3.000 në 8.000 fjalë. Në lidhje me këtë, Paneli rikujton se cilësia dhe efektshmëria e apeleve nuk varet nga gjatësia e tyre por nga qartësia dhe logjika e argumenteve të paraqitura, dhe, për pasojë, apelet e stërgjata nuk i shërbejnë synimit të administrimit të efektshëm të drejtësisë.¹² Po kështu, Paneli rikujton se kundërpërgjigja duhet të përqendrohet në argumentet që gjenden në

¹⁰ Vendim mbi Kërkesat për Ndryshimin e Afateve, para. 5; Vendim mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, para. 4-5; Vendim mbi Kërkesën e ZPS-së për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, para. 4-5.

¹¹ Vendim mbi Kërkesat për Ndryshimin e Afateve, para. 5; Vendim mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, para. 5; Vendim mbi Kërkesën e ZPS-së për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, para. 5.

¹² Vendim mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, para. 5; Vendim mbi Kërkesën e ZPS-së për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, para. 5.

përgjigje dhe të mos përmbajë pretendime të reja për gabime.¹³ Më tej, Paneli vëren se, pavarësisht se kishte kërkuar dhe kishte siguruar miratimin për shtimin e numrit të fjalëve për Apelin e tij,¹⁴ Selimi nuk i kishte shfrytëzuar 13.000 fjalët e miratuara për Apelin e tij, duke përdorur vetëm 8.479 fjalë.¹⁵

6. Për rrjedhojë, Paneli gjykon se kërkesa e Selimit për 5.000 fjalë shtesë për kundërpërgjigjen e tij nuk është as e përligjur, as e domosdoshme për rrethanat aktuale. Duke mbajtur parasysh numrin e shtuar të fjalëve të miratuara deri më tani për Apelin dhe Përgjigjen,¹⁶ Paneli gjykon se shtimi me 1.400 fjalë, duke arritur në maksimumin e 4.400 fjalëve, është i arsyeshëm dhe proporcional për rrethanat aktuale, dhe, në këtë mënyrë e ndryshon numrin e lejuar të fjalëve për kundërpërgjigjen e Selimit.

7. Panel rikujton se, bazuar ne nenin 36(2) të Udhëzuesit të Punës, parashtrimet për ndryshimin e numrit të lejuar të fjalëve mund të trajtohen pa u dhënë palëve kundërshtare mundësinë për të shprehur mendimin e tyre. Duke mbajtur parasysh se po afrohet afati për kundërpërgjigje ndaj Përgjigjes,¹⁷ Paneli është i bindur se nuk cenohet e drejta e palës kundërshtare. Për rrjedhojë, Paneli gjykon se është në interes të drejtësisë që të merret vendim i menjëhershëm lidhur me Kërkesën. Paneli po ashtu gjykon se është në interes të drejtësisë që shtimi i numrit të lejuar të fjalëve që miratohet me këtë Vendim, të zbatohet edhe për kundërpërgjigjet e gjithë të akuzuarve të tjerë të kësaj çështjeje.

¹³ Shih p.sh. ICTY, *Prosecutor v. Bralo*, IT-95-17-A, Decision on Prosecution's Motion to Strike and on Appellant's Motion for Leave to File Response to Prosecution Oral Arguments, 5 March 2007, para. 13; ICTR, *Nahimana et al. v. Prosecutor*, ICTR-99-52-A, Decision on Appellant Jean-Bosco Barayagwiza's Motion for Leave to Present Additional Evidence Pursuant to Rule 115, 5 May 2006, para. 8.

¹⁴ Shih F00007, Kërkesat e Mbrojtjes së Krasniqit, Selimit dhe Thaçit për Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, 16 gusht 2021; Vendim mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, para. 7.

¹⁵ Shih Apeli, f. 27.

¹⁶ Vendim mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, para. 7; Vendim mbi Kërkesën e ZPS-së për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve, para. 7.

¹⁷ Shih më lart, para. 3.

8. Për këto arsye, Paneli i Gjykatës së Apelit:

MIRATON Kërkesën pjesërisht;

AUTORIZON Selimin të dorëzojë kundërpërgjigjen e tij, me jo më shumë se 4.400 fjalë, jo më vonë se 18 tetori 2021; dhe

AUTORIZON që të ndryshohet në të njëjtën mënyrë numri i lejuar i fjalëve për kundërpërgjigjet e të akuzuarve të tjerë, në rast se do të ketë.

/nënshkrim/

**Gjykatësja Mishelë Pikar,
Kryegjykatëse**

E enjte, 14 tetor 2021

Hagë, Holandë